



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK



V E N D I M
Nr. 8, datë 18.01.2019

**PËR MIRATIMIN E PËRFAQËSUESVE TË QEVERISJES VENDORE NË
BORDET E INSTITUCIONEVE ARSIMORE PRIVATE NË BASHKINË
SHKODËR**

Këshilli Bashkiak Shkodër, në mbledhjen e tij të datës 18.01.2019, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, bazuar në nenin 55 pika 2 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, pika 1 e nenit 34 të ligjit nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, kreu 3 pika 7 e udhëzimit nr. 25, datë 25.07.2018 të Ministrisë të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, “Për ngritjen dhe funksionimin e bordit të institucionit arsimor”,

V E N D O S I :

1. Miratimin e përfaqësuesve të qeverisjes vendore Bashkia Shkodër në bordet e institucioneve arsimore private në Bashkinë Shkodër, sipas listës bashkëngjitur.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari e Bashkisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

Miratuar në datën 18.01.2019

Shpallur në datën 21.01.2019

Sekretar i këshillit

Suel Hadri



KRYETAR

Xhemal BUSHATI

Nr	Bashkia Shkoder- Institucioni Arsimor	Emri mbiemri i përfaqesuesit	Pozicioni
1	DITURIA	Jeta Xhabija	Përgjegjës, sektori i planifikimit strategjik, standarteve dhe monitorimit për shërbimet sociale, shëndetin publik
2	MARIA NDIHMETARE	Vilma Shiroka	Përgjegjës sektori i përfshirjes sociale
3	COR JESU	Andrea Ujka	Specialist, Qendra komunitare "Për familjen", nr. 5
4	ZEMRA E KRISHTIT	Redona Boriçi	Specialist i arsimit
5	HAXHI SHEH SHAMIA	Ergys Ivziku	Specialist, Qendra komunitare "Për familjen", nr. 2
6	HASAN RIZA PASHA	Ergys Ivziku	Specialist, Qendra komunitare "Për familjen", nr. 2
7	MIQESIA	Shkelqim Osmani	Specialist, Qendra komunitare "Për familjen", nr. 5
8	ABC	Vinifreda Gazulli	Përgjegjës Sektori, Sektori i arsimit, rinisë dhe sportit
9	PERPARIMI	Rudina Kruja	Specialiste, njësia e mbrojtjes së fëmijëve
10	PETER MAHRINGER	Redona Boriçi	Specialist i arsimit
11	DOM ALFONC TRACKI	Altin Kaçi	Administrator, njësia administrative Velipojë
12	ATË PJETËR MËSHKALLA	Vilma Shiroka	Përgjegjës sektori i përfshirjes sociale
13	SCUTARI	Gloria Shllaku	Specialist, Qendra komunitare "Për familjen", nr. 3
14	ZANI I SHKODRËS	Gloria Shllaku	Specialist, Qendra komunitare "Për familjen", nr. 3

Sekretar i këshillit


Suel Hadri

KRYETAR


Xhemal BUSHATI



Pp. 1727 04.02.2019



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT SHKODËR
SEKTORI JURIDIK

Nr. 94/1prot.

Shkodër, më 01.02.2019

LËNDA: Lidhur me vendimin Nr.8 datë 18.01.2019 të Këshillit Bashkiak Shkodër.

KËSHILLIT BASHKIAK SHKODER

Prefekti i Qarkut Shkodër, në zbatim të detyrave të tij funksionale të përcaktuara në ligjin Nr.107 dt.27.10.2016 “Për Prefektin e Qarkut”, të ligjit Nr.139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjit Nr.69/212 “Per sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 34 të Udhëzimit të Ministrisë të Arsimit, Sportit dhe Rinisë Nr.25 dt.25.7.2018 “Për ngritjen dhe funksionimin e bordit të Institucionit Arsimor”, Kreu III, pika 7, analizoi VKB Nr.8 datë 18.01.2019 “**Për miratimin e përfaqësuesve të qeverisjes vendore në bordet e Institucioneve arsimore private të Bashkise Shkodër**”.

Prefekti ju autorizon procedimin e mëtejshëm.

Me respekt,

P R E F E K T I

Çesk MILLJA

